



5/41-2

Kodi Etikë

Maj/2020

KODEKSI ETIK I STUDENTËVE

PRISHTINË, Maj 2020

Mbështetur në dispozitat e nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, Presidenti i “UBT-se”, Prof. Dr. Edmond HAJRIZI, në Prishtinë me datën **15.05.2019**, nxjerr:

KODEKSIN ETIK TË STUDENTËVE

I. VLERAT BAZIKE DHE PARIMET

Neni 1.

Studentet e të gjitha niveleve studimore (BACHELER dhe MASTER) tek BPrAL Kolegji UBT (me tej: “UBT-e”), në punën dhe sjelljen e tyre obligohen të promovojnë parimet bazë humane si dhe parimet profesionale.

Neni 2.

Studentet janë të detyruar që të kenë sjellje përgjegjëse duke zbatuar normat adekuate ligjore, normat artikuluar në aktet normative të “UBT-e”, të drejta bazë të njeriut, drejtësinë, lirit akademike dhe rregullat e sjelljeve kulturore dhe ndershmërisë kundrejt stafit mësimdhënës dhe të punësuarve tjerë në “UBT-e”, bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe vetë studentëve.

Neni 3.

Të drejta dhe detyrimet artikuluar në KODEKSIN ETIK TË STUDENTËVE të “UBT-e” (me tej: **Kodeksin**), ka të bëjë në veprimin dhe sjelljen e studentëve në hapësira që shfrytëzojnë dhe defilajn, si dhe në veprimet që në cilëndo mënyrë janë të ndërlidhura me paraqitjen dhe përfaqësimin e “UBT-se”.

Neni 4.

Është detyrim moral i secilit student që të ketë reflektim në çdo sjellje jo etike, respektivisht, shkelje të normave të këtij Kodeksi – nga kushto çoftë.

II. TË DREJTAT E STUDENTËVE

Neni 5.

“UBT-e” vlerëson dhe mbron të drejtat e studentëve në:

- pjesëmarrje në procesin mësimor,
- pjesëmarrje në punën e “UBT-se”,
- lirin e deklaramit në pajtim me parimet morale dhe normat ligjore,
- pjesëmarrje në diskutime dhe seanca,
- perfeksionim profesional dhe punë profesionale, punë në projekte dhe publikim të rezultateve dhe punëve profesionale,
- vlerësim objektiv dhe proces të drejtë të vlerësimit të punës,
- mbrojtje nga dhuna, detyrimi dhe kërcënimet me përdorim force,
- mbrojtje nga diskriminimi dhe shqetësimi mbi baza etnike, religjioze, përkatësisë nacionale, gjinisë, orientimit seksual, racës, moshës, shtatzënisë, gjendjes ekonomike dhe statusit prindëror, invaliditetit, pamjes fizike, gjendjes shëndetësore dhe orientimit politik,
- zgjedhje dhe përfaqësim, organizim demokratik studentor, dhe organizim përgjegjës bashkësie studentore

- përdorim të pasurisë të “UBT-se” për aktivitete jashtë mësimore me qëllim të përmbushjes të nevojave studentore nëse nuk janë në kundërshtim me normat e “UBT-se”, në përputhje me mundësit materiale të “UBT-se”,
- pranimin e studentëve dhe organizatave studentore tek organet përgjegjëse të “UBT-se”, me qëllim të paraqitjes të qëndrimeve të tyre me lajmërim dhe caktim termini paraprak,
- njoftimet me rregullat e normat e “UBT-se”, dhe qasjes në aktet normative të “UBT-se”,
- hapësirë të pastër dhe të shëndetshme e ekologjike pune.

III. DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 6.

Studentet e “UBT-se” kanë detyrime:

- të zbatojnë dhe të kenë sjellje konformë normave ligjore dhe normave paraprakë me akte normative të “UBT-se”,
- të përmbushin detyrimet e tyre studentore në përputhje të plotë me parimet e ndershmërisë dhe ndërgjeshmërisë,
- me sjellje vetjake të ruajnë shëmbëlltyrën e “UBT-se”, studentëve dhe të punësuarve të sajë,
- pasjen në konsideratë të tjerëve dhe mendimit ndryshe,
- të kërkojnë dhe mbështesin marrëdhënie të tolerancës dhe respektit së ndërsjellë,
- të kenë sjellje në përputhje me parimet e drejtësisë dhe barazisë në mënyrë që të përjashtohet çdo formë e diskriminimit, shqetësimit, mëkëmbjes, përdorimit të forcës fizike dhe shfrytëzimit,
- të marrë përgjegjësinë për deklaratimet e veta, veprimet dhe proceset,
- të merr pjesë aktive në ligjërata, punë shkencore dhe atë profesionale dhe të ngjashme,
- të ruaj rrethinën dhe pasurinë e “UBT-se”.

IV. SHKELJA E TË DREJTAVE DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 7.

Është i papranueshëm cilado shkelje e të drejtave dhe detyrimeve të studentëve përshkruar me këtë Kodeks të “UBT-se”.

Neni 8.

Shkelje të të drejtave dhe detyrimeve të studentëve konsiderohen të jenë:

- veprimet që paraqesin vepra të dënueshme të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe që sipas ligjit mund të shqiptohet dënimi me burg,
- veprimet që paraqesin vepra të dënueshme dhe atyre të kundërvajtjes të kryera kundër mësimeve dhe të punësuarve tjerë tek “UBT-e”, ose kundër studentëve tjerë,
- futjes së armëve zjarri dhe armëve tjera, ose mjeteve të përshtatshme për shkaktim të lëndimeve trupore,
- vjedhje e qëllimshme ose dëmtim të pronës së “UBT-se”,
- vjedhje e pasurisë së studentëve, mësimeve, të punësuarve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm,
- dëmtimi ose shkatërrimi i qëllimshëm i indeksit, respektivisht, publikimi i humbjes së indeksit me qëllim përfitimi të kundërligjshëm apo përfitimeve të të drejtave studentore,
- keqpërdorim ose falsifikim të lejes (aidisë) studentore,
- keqpërdorim ose falsifikim të indeksit, vërtetimit, evidencës dhe dokumenteve tjera zyrtare,
- shkelje të rendit dhe rregullave perceptuar për formë të ndryshme mësimore apo dhënie provimesh,

- pajisje, bartje dhe/apo përdorim të materialeve mësimore pa lejen e mësimdhënësve ose personave tjerë të autorizuar,
- shfrytëzim ose qëllimi i shfrytëzimit të shënimeve, të dhënave, llogaritjeve ose formave tjera të përdorimeve elektronike ose programeve gjatë orëve mësimore dhe notimit, nëse me urdhëresë paraprakisht janë të ndaluara,
- përshkrim të provimeve dhe kolokviumeve,
- plagjiaturë ose deformim të punimeve ose pjesëve të punëve të te tjerëve (esetë, punët e seminareve, punët përfundimtare diplome dhe magjistrature ose doktoratë, punimeve shkencore dhe të ngjashme,
- shfrytëzim, ose mos emërim të punimeve të te tjerëve pa përshkrim adekuat të burimit,
- keqpërdorim të hapësirave dhe mjeteve tjera materiale, pajisjeve informatike dhe pajisjeve tjera në pronësi të "UBT-se",
- keqpërdorim të ndalesave të publikuara dhe ndërmarrje të veprimeve të rrezikshme në hapësira të "UBT-se",
- nënçmim, shqetësim, trajtim të keq, përdorim dhune dhe diskriminimi nga cilado bazë qoftë,
- shkelje të rregullave të sjelljeve kulturore dhe ndershmërisë kundrejt mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe të punësuarve tjerë tek "UBT-e", respektivisht, kundrejt studentëve dhe qytetarëve në hapësirat e "UBT-se" ose hapësira publike,
- ardhja në mësim në gjendje të pirë ose nën ndikimin e përdorimit të substancave të drogës,
- pirja e duhanit në hapësirat e "UBT-se",
- shkelje të detyrimeve kontraktuale me "UBT-ën",
- të gjitha veprimet tjera që nuk janë në pajtim me etiken e vlerësimeve dhe normat e pranuar të sjelljeve shoqërore,

Neni 9.

Cilado shkelje e të drejtave dhe detyrimeve studentore përshkruar me Kodeks i nënshtrohet përgjegjësisë në pajtim me RREGULLOREN E PËRGJEGJËSIVE TË STUDENTËVE.

V. KOMISIONI ETIK

Neni 10.

Për shkelje të dispozitave të rregullores së këtij Kodeksi vendos KOMISIONI ETIK, i cili emërohet nga Rektori i "UBT-se" më propozim të Këshillit Akademik dhe Tubimit të Studentëve të "UBT-se".

Neni 11.

Këshilli përbehet nga pesë (7) anëtar, njeri nga të cilët është student.

Anëtari i studentëve merr pjesë në punën e Komisionit pa të drejtë vote me qëllim mbrojtjeje të te drejtave studentore.

Në punën e Komisionit nuk ka të drejtë të marr pjesë mësimdhënësi ose personi tjetër kodeksi etik i të cilit është shkelur.

Rektori siguron kushte normale pune për Komisioni.

Komisioni ka RREGULLOREN E PUNËS që me propozim të Komisionit pëlqimin e jep Këshilli Akademik, kurse, të njëjtin e miraton Rektori i "UBT-se".

Neni 12.

Për iniciimin e procedurës vendos Komisioni ne bazë të iniciativës vetjake ose me iniciativën e mësimdhënëse, të te punësuarve tjerë, studentëve apo personave tjerë te cilët konsiderojnë se janë shkelur dispozitat e këtij Kodeksi.

Neni 13.

Sallat e mësimi të “UBT-se” janë nën vëzhgim të kamerave, ashtu qe video regjistrimet edhe mund të përdoren si dëshmi dhe prova të shkeljes së te drejtave dhe detyrimeve të studentëve dhe bazohen edhe si bazë për iniciimin e procedurës se përgjegjësisë.

Neni 14.

Në rast të shkeljes së këtij Kodeksi Komisioni lëshon njoftim dhe lidhur me rastin njofton Rektorin e “UBT-se” pa vonesë.

Në rast se me shkeljen e këtij Kodeksi ka qar edhe në shkeljen e Ligjit, akteve tjera nënligjore ose akteve normative të “UBT-se”, Rektori ne afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit lidhur me rastin njofton organet kompetente.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 15.

Me lidhjen dhe nënshkrimin e KONTRATËS PËR STUDIME studenti pranon këtë Kodeks të Etikës Studentore, është i obliguar te njëjtin ta lexoi dhe kështu edhe të deklarohet se obligohet te ketë sjellje dhe veprim absolutisht në përputhje më të njëjtin.

Neni 16.

Kuptimet qe përdorën sipas këtij Kodeksi dhe qe kanë kuptim parimor, pavarësisht a janë shkruar në gjininë femërore apo mashkullore, përfshinë pa asnjë përjashtim të dy gjinitë.

Neni 17.

Ky Kodeks Etik Studentor hynë në fuqi ditën e publikimit të te njëjtit në rrjetin elektronik dhe Tabelë për Shpallje të “UBT-se”.

PRISHTINË,
Datë, 15.05.2019

BPrAL Kolegji UBT
Presidenti
Prof. Dr. Edmond HAJRIZI
